

**Rahim OMBASHI<sup>1</sup>**

## **Gjuha Shqipe Është Një E Mirë Kombëtare**

### **Abstract**

The purpose of the evaluative article is to support the scientific and national position of the language scholar Rami Memushaj. In the book “The Albanian Language on Procrustean Bed”, 2013, he took the responsibility of leading the defenders of the Albanian language, especially in support of the decisions of the Orthography Congress and the standard language in general. Memushaj urges the new generation of linguists, writers, translators, editors and journalists, ..., not to allow “some linguists with a dialect ear and a localist mindset” to turn standard Albanian “into a bastard Albanian”. It is asserted with facts that the Albanian language already has orthography and spelling, which were achieved after several successful stages. The Manastir Congress closed the first stage, paving the way for the stage of common Albanian. The Congress also took responsibility for the Arbëresh area. After the Liberation, the Dictionary of the Albanian Language (1954) was published, which was compiled by a commission of four Ghegs and one Tosk, but was written in the southern literary variant, contributing to making this variant, without any decree, the official language of the Albanian state. The Prishtina Consultation of April 1968 followed this path, whose motto, as Ali Hadri formulated it, was: “One nation – one literary language, one spelling.” Tirana, despite the deep political and ideological disagreements of the time between Albania and Yugoslavia, responded with the great project of the Orthography Congress, which was preceded by the discussion of the “Rules of Albanian Orthography” (1967). With A. Pipa's book "Language Policy in Socialist Albania" (1989), Memushaj emphasizes, where it is concluded that the standard language is "provincial linguistic colonization", because it was carried out "with revolutionary dictates", disputes began. They are not infrequently felt even today. Linguist Qemal Murati notes, "they are not worried about the language, but about the national rift ...". The scientific positioning through numerous publications, after the 2013 book, proves the principled and national stance of the scholar Memushaj. He received positive results in the year of the Albanian language 2024 when the achievements in the consolidation of the standard Albanian language stood out.

**Keywords:** *language, graphism, Monastery Congress, Orthography Congress, official language, standard language*

---

<sup>1</sup> Prof. Asoc. Dr. Rahim OMBASHI  
Kolegji Universitar Beder  
rombashi@beder.edu.al

Lidhur me temën e vlerësimit të gjuhës shqipe ka pasur studime të plota, me siguri do të ketë në vijim, ndaj vështirë se mund të sillet ndonjë gjetje e re e rëndësishme. Por në Vitin e Gjuhës shqipe, 2024, më duhet të jap disa konsiderata konkrete lidhur me qëndresën dinjitoze të profesor Rami Memushajt në mbrojtje të vendimeve të “Kongresit të Drejtshkrimin” të vitit 1972, si ngjarja e dytë madhore në historinë e dokumentimit të gjuhës shqipe, pas Kongresit të Manastirit apo të Alfabetimit.

“Gjuha është një nga veçoritë më të rëndësishme të njeriut.”, thotë ëndërrimtari vizionar i Shqipërisë që dëshirojmë, Sami Frashëri. Por kur ëndrra e kahershme nisi ngjizjen si realitet, ata që mundeshin dhe jo vetëm që dëshironin, duhet t’i futeshin grafizimit të gjuhës sonë të lashtë, si gjithë të tjerët e familjes gjuhësore indo-evropiane.

Mesrop Mashtotsi (361-440, teolog dhe gjuhëtar armen) te armenët, (krijoi në vitin 405 (Epoka jonë) alfabetin me 36 shkronja. Teksti më i vjetër mbijetuar në gjuhën armene është përkthimi i *Biblës* nga ai në shekullin V (Epoka jonë). Vëllezërit Kirili e Metodi te sllavët (shek. IX), arbnesi Gjon Bdek Buzuku (1499-1577) te shqiptarët (1555), janë vetëm pak shembuj të përpjekjeve për t’i futur popujt e vet në rrugën e qytetërimit me anë të gjuhës së shkruar.

“Një gjuhë e pashkruar është idiomë e një fisi a e një populli që ende nuk ka arritur të formojë një njësi politiko-geografike. Nevoja e grafizimit të gjuhës lind atëherë kur një bashkësi gjuhësore arrin një shkallë të atillë njësimi sa të krijojë një bashkim shpirtëror e politik të ngjashëm me shtetin.” (MEMUSHAJ, 2013: 9)

Etapa e grafizimit nis me “Formulën e Pagësimit” (1462), si përpjekja e parë për të dhënë me shenja grafike tingujt e shqipes, dhe përfundon me “Mesharin” (1555), ku shqipja del për herë të parë e shkruar me alfabet origjinal, veç me themel latin. Më pas shqipja u shkrua edhe me alfabet grek, fjala vjen “Bleta shqiptare” e Thimi Mitkos, 1878; më 1924 librin u përpoq ta latinizonte Gjergj Pekmezi; ka vlerë se në original mund ta lexojnë edhe grekët.

“Bleta” e Mitkos qe një libër i hapur edhe për trashëgiminë e arbëreshëve, edhe për këngë të shqiptarëve gegë, madje edhe për ndonjë vjershë alamiado (një prej tyre, me autor Hasan Zyko Kamberin – Koloniotin, sepse ishte nga Kolonja, ai e vlerësonte shumë lart). Studiuesi thekson:

“Kësisoj alfabetet pushuan së qeni kufij, dialektet pushuan së qeni kufij, ndarjet krahinore pushuan së qeni kufij, procesi homogjenizues po ecte për së mbari.” (MITKO, 2020: 23)

Me alfabet grek u shkrua *Fjalor i Gjuhës Shqipe* (Leksikon tis alvanikis glosis), u botua më 1904 në Athinë, pasi u dha leja nga qeveria greke. Fjalësi i mbledhur është me rreth 12 000 (11 675) fjalë, është dygjuhësh, shqip e greqisht. Fjalori pasi u ripunua dhe u transkriptua në alfabetin e shqipes së sotme prej A. Xhuvanit, u ribotua më 1961 me titullin *Fjalor Shqip-Greqisht*. Ajo është vepra e parë e leksikografisë shqiptare, përpjekja e parë drejt një fjalori shpjegues të shqipes. Shpjegimi bëhet kryesisht në shqip e greqisht, nganjëherë dhe në latinisht, turqisht e italisht; ai merr vlerë edhe si dëshmi e pasurisë leksikore me një shtrirje mbarëgjuhësore duke kaluar kufijtë e variacioneve gjuhësore të shqipes. Kësisoj fjalori dokumenton kontributin e K. Kristoforidhit edhe në formimin e gjuhës standarde shqipe.

“Si përfundim, do të vinim në dukje se ndihmesa në hedhjen e themeleve të një gjuhe letrare dëshmohet si e përbashkët për të dy këta lëvruet të shquar të shqipes. Njëri ishte nga Elbasani (R. O.: Konstandin Kristoforidhi) e tjetri nga Frashëri (R. O.: Naim Frashëri), por i përkisnin të njëjtit orientim kulturor e kombëtar, që do të përcaktonte në vija të trasha po atë rreth temash, kërkesash e kërkimesh, rrjedhimisht edhe po atë leksik, e më gjerë, po atë frymë gjuhësore.” (LLOSHI, 2001: 179)

Qëllimi i këtij *Fjalori*, sipas Xhuvanit, ishte në ndihmë të mësimin të shqipes për ata intelektualë shqiptarë që dinin greqisht, por nuk dinin të lexonin e shkruanin shqip.

Kristoforidhi bëri përpjekje të mëdha për ta botuar *Fjalorin* por nuk mundi. Pas vdekjes së tij ai rrezikoi bjerjen e dorëpasdoshme derisa përfundoi në arkivat e ministrisë së Jashtme të Greqisë. Sotir Peci që mësimet e mesme dhe studimet në degën matematikë-fizikë i ka përfunduar asokohe në universitetin e Athinës, i nxitur nga prirjet e pasioni i tij letrar, iu bind detyrimit për të marrë përsipër botimin e *Fjalorit të Gjuhës Shqipe*, që, deri atëherë, ishte vepra më madhore e gjuhës shqipe. Prandaj, çështja e parë që duhet zgjidhur për shkrimin e një gjuhe, thekson Memushaj, është grafizimi i saj, kurse produkti i këtij procesi është alfabeti i asaj gjuhe.

Me alfabet arab të përshtatur për shqipen shkruan disa autorë alamiado (më i madhi syresh Nezim Frakulla apo Nezim Berati me *Divanin* e parë shqip; një kopje tij e transkriptuar me alfabetin grek, ruhet në Arkivin e Shtetit Shqiptar).

Për tre deri katër shekuj, shkolla letrare e vjershëtarëve të spikatur, Nezim Berati (shek. 17 -1760), Hasan Zyko Kamberi (shek. 18 - shek. 19) dhe Muhamed Kyçyky (1784-1844), kjo shkollë u bë një shkollë e mirëfilltë letrare ku zbulohet autori, “madje si subjekt i shkrimit,” (HAMITI, 2010: 146). Shqipja vijoi të shkruhej edhe me alfabete origjinale duke nisur me *Ëvetaret* e N. Veqilharxhit

e të tjerë më këtej. Gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare u përdoren rreth 50 sosh. Një nga më të përdorurit ishte alfabeti i *Shoqërisë së të Shtypurit Shkronja Shqipe*, apo Alfabeti i Stambollit, siç thirrej zakonisht shkurt alfabeti i vendosur në atë shoqëri më 12 tetor 1879.

Bashkë me njësimin e kërkesave kulturore e kombëtare, u kërkua edhe njësimi i gjuhës sipas një standardi. Një nga prijësit e shoqërisë investoi një veprimtari të gjerë në punë të formimit të gjuhës letrare shqipe:

“Nga një vështrim i përgjithshëm kemi krijuar një mendim e bindje të ngulitur se Naimi – poeti i madh dhe veprimtari i dalluar ndër inteligjencien e kohës së Rilindjes Kombëtare, në punë të formimit të gjuhës letrare shqipe investoi një veprimtari të gjerë, derdhi mund, shkriu energjitë e tij për përsosjen e këtij mjeti të fortë, të pazëvendësueshëm në punë të përparimit e të zhvillimit të kombit – siç thoshte vetë Naimi.” (AJETI, 2001: 119)

Sabri Hamiti shkon më tej në vlerësimin e apostullit të kombit për ngjizjen e gjuhës shqipe kur shkruan:

“Naim Frashëri (1846-1900), njësoj i rëndësishëm si apostull i kombit, si poet e si krijues i gjuhës letrare shqipe, krijoi himnin për vendin me veprën *Bagëti e Bujqësi* (1886), himnin e dashurisë me poemën *Bukurija* (1890) dhe himnin për heroin nacional me epin *Skënderbeu* (1898).” (HAMITI, 2010: 148)

I takon ky përcaktim poetit të madh që jo vetëm e ka njohur vlerën përbashkuese e qytetarizuese të gjuhës, por dhe ka mbështetur lëvrimin e saj. Këtë e ka vënë në dukje albanologu i mirënjohur austriak Norbert Jokli në studimin e vet: “Naim Frashëri e pasunimi i gjuhës shqipe”, punim i përfshirë në librin kushtuar poetit me rastin e 25-vjetorit të vdekjes së tij, botuar në Grac në vitin 1925,

“Kish të drejt i gjori Laipniç, që thosh: m’epni shkronja të mira, t’u ap gjuhë të bukurë; m’epni gjuhë të bukurë, t’u ap qytetëri të mbaruarë.” (FRASHËRI, 1899: 36)

Këtë ndihmesë me ndikim të bashkëkohësit apo krijuesit e mëvonshëm e ka vënë në dukje Shaban Demiraj:

“Gjithsesi, puna themelvënëse e Naimit dhe e bashkëkohësve të tij të shquar, Kristoforidhit, Samiut etj., ka ndihmuar me siguri në qëndrimin, që mbajtën në lëvrimin e gjuhës shqipe një varg shkrimtarësh të tjerë, ndër të cilët duhen veccuar, Faik Konica, Ndre Mjeda, Gjergj fishta, Fan Noli, Lasgush Poradeci etj.” (DEMIRAJ, 2001: 135)

Pasurimi i gjuhës shqipe eci në gjitha stilet funksionale të gjuhës, por për arsye themelore doli në krye, siç vëren në monografinë e vet studiuesi Samara, stili i veprimtarisë ligjërimore më të gjerë e më të dendur, asaj për çështje shoqërore dhe politike. Koha historike e Rilindjes Kombëtare i dha krahë pasurimit veçmas të leksikut politik e shoqëror, lidhur drejtpërdrejt me nevojat që kishte gjuha dhe populli ynë për fjalë e terma që shënojnë koncepte të reja në fushën e mendimit politik dhe të shkencave shoqërore (humanitare). (SAMARA, 2008: 6)

E gjithë kjo veprimtari kombëtare dhe vlerë kulturore masive i çeli udhë grafizimit të gjuhës, që po futej në etapën e parë të tij. Në nisje të “shekullit të madh të letërsisë shqipe” konteksti socio-politik, kulturor e historik u bë mbështetës për ecurinë positive të grafizimit të gjuhës shqipe:

“Në decenien e parë të shekullit (1908) në Manastir u hartua alfabeti shqip si veprim themelor i njësimi kulturor të kombit... Në decenien e tetë u mbajt *Kongresi i Drejtshkrimit* si hap themelor i krijimit të gjuhës standard shqipe, që synonte njësimin kombëtar në fushë të gjuhës e të shkrimit.” (HAMITI, 2010: 348)

Kongresi i Alfabetit kryer në Manastir e mbylli etapën e parë me gjetjen e një alfabeti të njësuar me 36 grafema për 36 fonema duke i çelur udhë etapës së shqipes së përbashkët. (MEMUSHAJ, 2013:13) Këtu duhet theksuar, sipas gjuhëtarit Matteo Mandala’, se Kongresi mori përgjegjësi edhe për trevën tjetër të rëndësishme shqipfolëse, arealin arbëresh, kur pranon:

“Pajtohemi plotësisht me përfundimin e Shaban Demirajt sipas të cilit arbëreshët nuk arritën të kishin një alfabet të përbashkët për shkak të heterogjenitetit kulturor dhe gjuhësor që karakterizonte komunitetin e tyre.” (DEMIRAJ, 2017: 6)

Ndërkohë që po te libri i Shaban Demirajt “Historia e gjuhës së shkruar shqipe”, te *Dy fjalë hyrëse*, Mandala’ thekson se është me përfundimet e Demirajt:

“Pajtohemi me përfundimet e prof. Demirajt, sidomos kur e vënë theksin te përpjekjet e intelektualëve të Rilindjes për të shkurtuar distancën mes toskërishtes dhe gegërishtes, çka i hapi rrugën procesit të formimit të një gjuhe letrare kombëtare.” (DEMIRAJ, 2017: 6)

Lidhur me çka ishte arritur deri në atë periudhë kohore, gjuhëtarit Mehmet Çeliku vëren, “përzgjedhja e toskërishtes letrare si variant bazë i shqipes së përbashkët i ka fillimet shumë kohë më parë, që në miratimin e dy alfabeteve kombëtare”.

Pas vendimit të spikatur kombëtar, vijuan aktivitetet për sendërtimin e tij. Në shtator 1909 u mbledh në Elbasan “Kongresi i Shkollave Shqipe”, i cili sugjeroi që shqipja të shkruhej në dialektin e Elbasanit. Sugjerimin real e bëri Vendim që e zbatoi Komisia Letrare e Shkodrës (1916), nën drejtimin e Gjergj Pekmezit (1872-1938), që shënon kështu formimin e një shqipeje “zyrtare”, në vend të gjuhës turke, e cila përdorej ende asokohe në shkrimin e dokumenteve.

E pëlqeu si zgjidhje të mençur Luigj Gurakuqi, e përkrahu Gjergj Fishta dhe slloveni i shkolluar në Austri Rajko Nahtigal (1877-1958), më pas vendimi u tumir nga Kongresi Arsimor i Lushnjës (1920) dhe që me një vendim të qeverisë shqiptare të vitit 1923, ai u bë i detyrueshëm.

Megjithë tërë ato vendime, elbasanishtja letrare e Aleksandër Xhuvanit nuk u pranua as nga rrethet kulturore shkodrane, as nga rrethet kulturore toske, që vijuan të shkruanin secili në variantin e vet. Siç vëren S. Riza, “qarqet letrarë e gjuhësorë të Shkodrës elbasanishten e A. Xhuvanit, kur e kanë përfillë, e kanë përfillë vetëm për ta luftue”.

Kritika të rrepta pati sidomos për vështirësitë e zbatimit të parimit etimologjik. Ndërkohë që lidhur me këtë parim gjendet një pohim i rëndësishëm i Shaban Demirajt:

“Më drejt, mendojmë, veproji Kristoforidhi, i cili duke zbatuar shpesh në ortografinë e tij të gegërishtes edhe parimin historic-tradicional, i afroji mjaft në të shkruar të dy kryedialektet e shqipes, që në kohën e tij ishin larguar mjaft nga njëri-tjetri.”

(DEMIRAJ, 2017: 99)

Vinçens Prenushi arrin ta quajë vendimin e Komisionit “atentat që i ba’het gjuhës shqipe”. Pas qëndrimeve të tilla edhe nga personalitete, dijetari Memushaj detyrohet të thotë,

“Nuk mund të mos vëmë në dukje një pohim të dhimshëm por të saktë se mospranimi i një vendimi të marrë më parë, përbën një sëmundje të shqiptarëve.”

Këtë vlerësim konceptual Memushaj e jep te botimi *Gjuha shqipe në shtratin e Prokrustit*, 2013, mbasi deklaron një kokë mbi kolegët gjuhëtarë, në mbrojtje të gjuhës standarde shqipe, sulmuar emocionalisht por pa argumente shkencore.

Në libër ai jep faktin se Fishta e miratoi vendimin e Komisionit, çka dëshmohet nga dokumentacioni i botuar; po, si individ, e kundërshton. Kjo sëmundje duket edhe te Mithat Frashëri, i cili edhe pas

Kongresit të Manastirit, që u kryesua prej tij, vijon të përdorë në shkrimet e veta alfabetin e Shoqërisë së Stambollit (Shoqërisë së të Shtypurit Shkronja Shqipe).

Pas Çlirimit, me krijimin më 1947 të Institutit të Shkencave, gjuhëtarët morën detyrën për hartimin e ortografisë, *Gramatikës* (1949), *Sintaksës* (1952). Sukses i gjuhësisë së kohës ishte dalja nga botimi i *Fjalorit të Gjuhës Shqipe* (1954), që u hartua nga një komision prej katër gegësh e një toske, por u shkrua në variantin letrar jugor, duke kontribuar për ta bërë këtë variant, pa ndonjë dekret, gjuhë zyrtare të shtetit shqiptar. Ky normalizim dhe stabilizim i ndihmoi njësit të abetares.

#### PUNA PËR DREJTSHKRIMIN NË TROJET SHQIPTARE NË ISH-JUGOSLLAVI

Pas LIIB, gjuha shqipe u pranua si gjuhë zyrtare rajonale, u njoh barazia e gjuhës shqipe në administratën shtetërore dhe u lejua hapja e shkollave në gjuhën shqipe. Konteksti i ri politiko-administrativ, kulturor dhe gjuhësor herë afrohej e herë veçohet prej ecures që po ndodhte në Shqipëri. Kështu ndodhi deri te Konsulta e Prishtinës e prillit 1968, deviza e së cilës, ashtu siç e ka formuluar Ali Hadri, ishte: “Një komb – një gjuhë letrare, një drejtshkrim”. Dhe Tirana, me gjithë mospajtimet e thella politike dhe ideologjike të kohës midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, u përgjigj me projektin e madh të Kongresit të Drejtshkrimit, i cili u parapri nga diskutimi i “Rregullave të drejtshkrimit të shqipes” (1967).

Theksojmë se gjuha e shkruar luan rol themelor në procesin e standardizimit. Në Kongres u mbajtën referati “Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj” nga A. Kostallari dhe 104 kumtesa, 94 për çështje të ndryshme të drejtshkrimit dhe 12 për gjuhën letrare. Rezoluta e tij u nënshkrua nga 86 delegatë; nuk nënshkroi vetëm Lazgush Poradeci. Në rezolutë, te pika e parë janë vendosur parimet themelore të rregullave të drejtshkrimit: fonetik; morfologjik, historik-traditional, simbolik. Kongresi porositi që, “duke marrë parasysh ndryshimet që pëson gjuha letrare gjatë zhvillimit të saj si edhe çështjet e reja që nxjerr praktika gjuhësore, rregullave të drejtshkrimit t’u bëhen, në të ardhmen, kur të jetë e nevojshme, përmirësimet dhe plotësimet e duhura”. Rezoluta caktoi si detyrë që brenda vitit 1973 të hartoheshin “Rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe”; brenda vitit 1974 të hartoheshin “Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe” dhe brenda vitit 1975 të hartoheshin “Rregullat e drejtshqiptimit”, që deri sot nuk u realizua ende dhe “Rregullat e pikësimit”.



## KONTESTIMET NDAJ KONGRESIT DHE GJUHËS STANDARDE

Me librin e A. Pipës “Politika gjuhësore në Shqipërinë socialiste” (1989), ku arrihet te përfundimi thellësisht i politizuar, pas një analize të pambështetur shkencërisht se gjuha standarde është “kolonizim gjuhësor krahinor”, sepse u krye “me diktat revolucionar”, zunë fill kontestimet ndaj Kongresit, që jo rrallëherë ndihen edhe sot.

Nën kryesimin e Pipës së kthyer në atdhe, u organizua në Shkodër më 26 korrik 1992 një tryezë e rrumbullakët nga doli “Deklarata e gjuhëtarëve të Shkodrës”, nënshkruar nga 420 nënshkrues. Tezat themelore ishin:

- a) Gjuha letrare e “njësuar” duhet të rishikohet.
- b) Krahas të shkruhet gegënishtja letrare
- c) E ardhmja e letrarishtes shqipe do t’i lihet momentit të favorshëm.

Këto teza u rimorën edhe në tubime të tjera mbi gjuhën standarde. U krijua kësisoj një frymë antistandarde, ku u bashkuan jo pak kontribues. Gjuhëtari Qemal Murati vëren, “nuk e kanë hallin te gjuha, por tek çarja kombëtare: gegnishte letrare / toskërishte letrare (Veri-Jug), mëtohej për një kosovarishte standarde (Shqipëri-Kosovë), e që do të pasohej më tej me çarje me shqiptarët e Maqedonisë, të Malit të Zi, të Luginës së Preshevës e kështu pa fund”. U shqetësua R. Qosja, kurse I. Kadare i quajti propozimet “mllefe” kundër gjuhës së përbashkët.

Në mbrojtje të gjuhës standarde u hodhën ASHSH dhe ASHK që krijuan Këshillin Ndërkademiq për Gjuhën Shqipe (KNGJSH) më 27 tetor 2004, por shpejt ASHAK iu fut linjës së mohimit të Konsultës së Prishtinës, viti 1968.

Ndërkohë që vijonte turbullimi i jetës kulturore të vendeve tona, QSA me drejtues Ardian Marashin fton për një konsultë për gjuhën shqipe të planifikuar në Tiranë në nëntor 2010, e cila do të përgatiste një konferencë shkencore. Ajo u mbajt nga data 15-17 dhjetor në Durrës duke synuar një standard të dyzuar hibrid.

ASHSH pezulloi veprimtarinë e Këshillit Ndërkademiq (KN) për Gjuhën Shqipe, ndërkohë dy akademitë miratuan në dhjetor 2011 rregulloren e kryesisë së Këshillit Ndërkademiq. Dy bashkëkryetarët e KN J. Thomai dhe R. Ismajli, ndonëse pohojnë se Këshilli nuk ka tagër të vendosë rregulla të reja të drejtshkrimimit, përpiqen të gjejnë format dhe rrugët për t’i anashkaluar institucionet gjuhësore ekzistuese. (Memushaj, 2013: 69)



Gjatë periudhës kohore 40-vjeçare shqipja standarde vijoi konsolidimin, që dëshmohet me hartimin dhe botimin në gjuhën standarde të veprave, si:

- Tahir. N. Dizdari\_(2005) *FJALOR i Orientalizmave në Gjuhën Shqipe* (Rreth 4500 fjalë me prejardhje nga gjuhët turke, arabe dhe perse). *Fjalori ynë Kombëtar* (1980) *FJALOR I GJUHËS SË SOTME SHQIPE*, si e quan leksikologu Hajri Shehu fjalorin e parë shpjegues, tani - *fjalori.shkenca.org*, merret (online), 1984, 2006 me rreth 48 mijë fjalë, etj.) *Fjalor i gjuhës shqipe*, 1954: K. Cipo, E. Çabej, M. Domi, A. Krajni, O. Myderrizi; Shtëpia botuese: Çabej, Viti: 2005, Fq. 654. (Ribot.)

ASHSH në bashkëpunim me institucionet e tjera, sidomos me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe me universitetet, punojnë për të hartuar “Fjalorin e madh të gjuhës shqipe” (del së shpejti), “Historinë e shqiptarëve” dhe “Enciklopedinë kombëtare”.

#### VËREJTJET NDAJ PROJEKTIT NDËRAKADEMIK TË DREJTSHKRIMIT

Këshilli Ndërakademik miratoi në dy mbledhje disa ndryshime të drejtshkrimit. Sipas rregullit ndërakademik synohej heqja e zanores “ë” në jo pak raste, ndryshimi i drejtshkrimit të disa bashkëtingëlloreve, në drejtshkrimin e antroponimeve të huaja, përdorimi i shkronjave të mëdha. Një grup gjuhëtarësh kundërshtues i rikujtuan KN se rivlerësimi i normave është gjithmonë detyrë e fazës së re të etapës III, asaj të kultivimit a elaborimit të gjuhës, që vinte pas kodifikimit e planifikimit gjuhësor.

Që në Kongresin e Drejtshkrimit, A. Kostallari ka vënë në dukje se “me kodifikimin e normës së përbashkët, kanë dalë në plan të parë çështjet e kulturës së gjuhës, që lidhen drejtpërdrejt me përforcimin e me përsosjen e normës letrare kombëtare”. Ndryshimet e normës drejtshkrimore dhe morfologjike janë dëshmi e asaj se “kristalizimi përfundimtar i normës” në të vërtetë nuk është kurrë përfundimtar, i përjetshëm, statik; ai duhet kuptuar si vendosje e një qëndrueshmërie tipike, por relative të normës, e cila është dinamike, zhvillohet e përsoset”. (MEMUSHAJ, 2013:125)

#### KUNDËR DREJTSHKRIMIT NDËRAKADEMIK

Në thelb, projekti për ndryshimin e drejtshkrimit është vijim i përpjekjeve për rishikimin e bazës së gjuhës standarde. Deri anëtarë të kryesisë së KN, pa futur këtu një sërë gjuhëtarësh të sapo dalë nga auditoret universitare “albanologë të rinj”, siç i quan I. Kadareja, kanë nyjtuar një varg tezash që i bëjnë dëm njësisë gjuhësore dhe kombëtare të shqiptarëve. Projekti ndërakademik po jetëson përpjekjet “më të sofistikuara a më të vrazhda për cënimin, madje, për rrënimin e parimeve mbi të

cilat është ndërtuar ajo”, vëren R. Qosja. Projekti në thelb është një kthim pas te ortografia separate e Prishtinës e 1957-s, e qortuar nga I. Ajeti. Ky projekt propozon disa zgjidhje që shkojnë edhe përtej ortografisë së Komisionit Letrarez, siç është vendi për shkrimin ndryshe të dhjetëra ortogrameve me traditë qëndrore, si *britm, buz, hasm, shter, qurra, bulmet* etj.

Kriticizmi i disa anëtarëve të KN i është përveshur keqas dukurisë së *rotacizmit* dhe përgjithësisht fonemës *r*. Çfarë nuk thuhet nga njëri syresh duke analizuar vargun e M. Camajt “Eshtna ndër eshtna ndër shtresa petkash të leshta”. Ai nuk ndalet me kaq. Kundërshtari i standardit dhe me të partizanët e “rishikimit” të drejtshkrimit kërkojnë mosshkrimin e zanores *ë* të patheksuar me arsyetime të pabaza, duke harruar se bukurtingëllimi, melodiciteti madje eleganca (edhe e bukur edhe e thjeshtë) janë veçori që gjuha standarde shqipe i ka prej *ë-së* së patheksuar. Memushaj mendon se prapa grishjes dhe përpjekjes për ta “zgjerrur këmbësorin e standardit”, qëndrojnë jo vetëm rrethet politike në Prishtinë dhe në Tiranë, po edhe rrethet të caktuara fetare. Thënë shkurt e thjesht, sipas gjuhëtarit, kemi përpara një “atentat kundër gjuhës shqipe”.

Po të mos harrojmë që gjuha nuk është vetëm mjete kryesor i komunikimit, por dhe tregues i rëndësishëm i dokumentimit të origjinës së shqiptarëve, kuptohet roli i rëndësishëm i saj:

“35. At the conclusion of this book, we would like to emphasize once more that, in absence of direct historical evidence, the diachronic investigation of the Albanian linguistic data can greatly contribute to solve the difficult problem concerning the origin of Albanians and their idiom. And the linguistic facts analyzed in this work clearly indicate that the forefathers of the Albanians were the northern and north-western neighbors of the ancient Greeks and for a long-time subject of the roman Empire. Thus, the opinion of various scholars sustaining the (south-) Illyrian origin of the Albanians is steadily confirmed by numerous diachronically investigated data of Albanian language.” (DEMIRAJ, 2021: 211)

“35. Në përfundim të këtij libri, dëshirojmë të theksojmë edhe një herë se, në mungesë të dëshmive të drejtpërdrejta historike, hulumtimi diakronik i të dhënave gjuhësore të shqipes mund të kontribuojë shumë në zgjidhjen e problemit të vështirë për origjinën e shqiptarëve dhe idiomën e tyre. Dhe faktet gjuhësore të analizuar në këtë vepër tregojnë qartë se paraardhësit e shqiptarëve ishin fqinjët veriorë dhe veriperëndimorë të grekëve të lashtë dhe për një kohë të gjatë subjekt i Perandorisë Romake. Kështu, mendimi i studiuesve të ndryshëm që mbështesin origjinën (jug-) ilire të shqiptarëve konfirmohet në mënyrë të qëndrueshme nga të dhëna të shumta të hulumtuara në mënyrë diakronike të gjuhës shqipe.”

Lypset theksuar se gjuhëtarët me kontribute në këto lëmi të gjuhësisë, janë gjithnjë të gatshëm për nevojën e përmirësimit, pra të rivlerësimit të pikave të veçanta të kodit drejtshkrimor. Shihet qartë

ky qëndrim në tekstin e R. Memushajt “Shqipja standarde” (2002), tekst themelor që përdoret qysh prej çeljes së Universitetit “Bedër”, ribotuar çdo dy-tre vjet, por dhe më qartë me veprën me bashkautorësi Ali Dhrimo - Rami Memushaj (2015) *Fjalor Drejtshkrimor i Gjuhës Shqipe*, INFBOTUES, Tiranë, Mbi 81 000 fjalë dhe 300 000 fjalëforma; i pajisur me rregulla të drejtshkrimit dhe të pikësimit.

Shqetësimet që lidhen me rivlerësimin e kodit drejtshkrimor duket që kanë shkuar shumë larg, deri matanë oqeanit Atlantik, ku banojnë e jetojnë jo pak shqipfolës. Kështu, në ditën e fundit të tetorit Ardian Vehbiu, që nga SHBA ka ardhur në Tiranë me librin e tij të fundit, në një mënyrë të papraktikuar më herët promovon librin "Përrallëtarët e gjuhës shqipe", ku stigmatizon sharlatanët albanofonë, bashkë me atë që anekdotikisht do të njihet si "gjuhësi alternative". Ngjarja shkencore dhe kulturore u zhvillua në sallën franceze të seksionit "Sotir Kolea" të BKSH. Atje “punëtori i gjuhësisë” (SHAMKU-SHKRELI, 2007: 9) me qasje të afërt me semantikën e ligjërimeve tona, mbajti ligjëratën "Rreth krizës së autoritetit në albanologji", ku u qesëndisën e ironizuan “turboalbanologët klinikë e të pashërueshëm, viktima të psikozës nacionaliste”. Mbrëmja ishte përndryshe e qetë dhe edukative, ndonëse te fryma e saj spikati grishja atdhetare që pikoi natyrshëm nga tubimi: “Të ndërpritet shiu me baltë!”

“Brezi i ri i gjuhëtarëve, letrarëve, përkthyesve, redaktorëve dhe i gazetarëve, i rritur me tingëllimin e ëmbël të gjuhës së përbashkët letrare, që të folmet nuk i ka fare pjesë të repertorit të vet gjuhësor ose i ka si kod të dytë, nuk duhet t’i lejojë disa gjuhëtarë me vesh dialektor dhe me mendësi lokaliste ta kthejnë shqipen standarde “në një shqipe bastarde”, duke ia prishur drejtshkrimin dhe drejtshqiptimin.” (MEMUSHAJ, 2013: 7)

## **BIBLIOOGRAFI**

- ASHSH-IGJL. (2001) *NAIM FRASHËRI DHE KULTURA SHQIPTARE*, Tiranë:
- AJETI, Idriz. *NDIHMESA E NAIM FRASHËRIT PËR FORMIMIN E GJUHËS LETRARE SHQIPTARE*.
- ASHSH-IGJL. (2001) *NAIM FRASHËRI DHE KULTURA SHQIPTARE*, Tiranë:
- DEMIRAJ, Shaban. *NDIHMESA E NAIM FRASHËRIT PËR LËVRIMIN E GJUHËS SHQIPE*.
- DEMIRAJ, Shaban. (2017) *HISTORIA E GJUHËS SË SHKRUAR SHQIPE*. Tiranë.
- DEMIRAJ, Shaban. (2021) *THE ORIGIN OF ALBANIANS* (linguistically investigated). Ribot. Tiranë.
- FRASHËRI, Naim. (1899) *ISTORI E SHQIPËRISË*, Botues 'Mbrothsia', Sofje.
- HAMITI, Sabri. (2010) *POETIKA SHQIPE*, Tiranë.
- ASHSH-IGJL. (2001) *NAIM FRASHËRI DHE KULTURA SHQIPTARE*, Tiranë:
- LLOSHI, Xhevat. *NAIM FRASHËRI DHE KRISTOFORIDHI*.
- MEMUSHAJ, Rami. (2013) *GJUHA SHQIPE NË SHTRATIN E PROKRUSTIT*. Tiranë.
- MITKO, Thimi. (2020) *BLETA SHQIPTARE, SHKRIME TË TJERA DHE DOKUMENTE NË DY VËLLIME*, A. Përgatiti Dhorë Q. Qiriazi.
- SAMARA, Miço. (2008) *RRETH LEKSIKUT POLITIK E SHOQËROR NË GJUHËN SHQIPE*. Tiranë.
- VEHBIU, Ardian. (2007) *SHQIPJA TOTALITARE* Tipare të ligjërimit publik në Shqipërinë e viteve 1945-1990, Tiranë:
- SHAMKU-SHKRELI, Ledi. *PËRTEJ LIGJËRIMIT TOTALITAR*.